

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1238 Prot.

Tiranë, më 05.12 2016

VENDIM Nr. 140, datë 22.11.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA)" (i ndryshuar), si dhe Vendimit Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA "Rregullore mbi Kriteret e Ushtrimit të profesionit të arkeologut; Kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike; Kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte private", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" dhe "A2" të Z. Surja Lela,*

VENDOSI:

1. Të mos miratojë *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" dhe "A2" të Z. Surja Lela*, për arsye të mospërbushjes së pikave të nenit 13 të Rregullores së sipërpërmendur, sipas të cilave individë duhet të jetë pajisur me "Diplomë shkolle pasuniversitare (master i nivelit të dytë) për arkeologjinë brenda ose jashtë vendit, të njohur nga MASH, në arkeologji dhe nëndegët e saj"(A1) dhe individë duhet të jetë pajisur me "Gradë Doktor në fushën e arkeologjisë dhe nëndegët e saj brenda ose jashtë vendit, e njohur nga MASH, për rastet e gërmimeve arkeologjike me karakter studimor (A2).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
RUDINA ZOTO